

Pse “gazetari qytetar” ka nevojë për edukim mediatik?

Lorin Kadiu

Sot qytetari është njëkohësisht konsumator dhe prodhues i lajmit. Uria e natyrshme për informacion 24/7, tani ushqehet jo vetëm nga ekranet televizive apo shtypi i shkruar por edhe nga kanalet e rrjeteve sociale në telefonat celular, shpesh në formën e njoftimeve apo mesazheve mbi lajmit të fundit.

Ajo që shpesh anashkalohet është fakti se sot shumë qytetarë kanë në dorë mjete me potencial shumë të ngjashëm me atë të gazetarëve profesionist. Megjithatë, të paktë janë ata që kanë aftësitë e duhura për të prodhuar lajme, apo njohuritë dhe trajnimin që do t'i bënte kontributorë të vëmendshëm dhe kritik të përmbajtjes mediatike.

Përhapja e gjerë e aksesit në media ka krijuar idenë e përgjithshme se në parim çdokush mund të praktikojë lehtësisht gazetarinë qytetare. Në këtë situatë qytetari përballet me probleme që janë të ngjashme me ato të gazetarëve. Mungesa e aftësive të duhura të edukimit mediatik mund ta bëjë atë të bjerë lehtësisht në vetë censurë apo në prodhimin e përmbajtjes së pavërtetë.

Për ta sqaruar këtë, është me rëndësi parashtrimi i vetë definicionit të gazetarit qytetar për të cilin platforma “WeMedia” e Institutit Amerikan të Shtypit (American Press Institute) përdor këto fjalë: *“Veprimi i një qytetari, apo grupi qytetarësh, që luan një rol aktiv në procesin e mbledhjes, raportimit, analizimit dhe shpërndarjen e lajmit apo informacionit. Qëllimi i këtij veprimi është përçimi i informacionit të pavarur, të besueshëm dhe relevant për demokratizimin mediatik.”*

Gazetari qytetar i shekullit XXI ka potencialin të kthehet në krijuesin, mbështetësin dhe ndërtuesin kryesor të medias demokratike. Të pajisur me mjetet dhe njohuritë e duhura, qytetarët kanë mundësinë të mbushin hapësirat e pa përfaqësuar nga mediat e mëdha, për shkak të axhendave të diktuar nga interesa ekonomike apo politike, veçanërisht në vendet me demokraci jo të zhvilluar.

Në mjedise ku kushtet ekonomike apo politike e bëjnë të vështirë ekzistencën e medias tradicionale të pavarur – gazetari qytetar mund të marrë kontrollin dhe përgjegjësinë si për krijimin e produktit mediatik, ashtu edhe për mbështetjen dhe ekzistencën e medias alternative të pavarur. Njohuritë mbi gazetarinë qytetare mund të shtrihen në disa fusha kryesore:

- Edukimi mbi standardet, etikën dhe rolin e medias – Ky set aftësish i mundëson gazetarëve qytetarë, jo vetëm të aftësohen në teknikat e krijimit të lajmit, por edhe të jenë vlerësues të informacionit që konsumojnë si edhe të kuptojnë rolin që media e pavarur luan në sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës në një shoqëri.
- Edukimi mbi përdorimin e përgjegjshëm të platformave teknologjike – Në kohën kur platformat informative po shkojnë gjithmonë e më shumë drejt ndërveprimit, qytetarët kanë nevojë të aftësohen si në pozitat e konsumatorit të lajmit, ashtu edhe në përdorimin e përgjegjshëm të fuqisë që i jep roli i përçuesit dhe krijuesit të informacionit.
- Krijimi i lajmeve që janë njëkohësisht të sakta dhe interesante – Blogerët, opinion-bërësit dhe influencersit online mund të aftësohen për tu kthyer në burime të besueshme të

lajmit. Vendorsja dhe aderimi drejt standardeve mundet që ta edukojë publikun edhe nëpërmjet kanaleve jo të sofistikuara.

- Rrjetëzimi përtej lokalitetit dhe krijimi i zërave alternativë ndaj medias tradicionale – Ndërlidhja mes grupeve të ndryshme të gazetarëve qytetarë krijon rrjedha të reja informacioni që shkojnë përtej limitimeve gjeografike. Aftësimi i qytetarëve që gëzojnë njohuri mbi teknologjinë mbi praktikën më të mira të gazetarisë së thelluar, verifikimit të fakteve dhe investigimit mund t'i japë atyre besimin e duhur për të ngritur zërin mbi çështje që i prekin drejtpërdrejtë.

Edukimi mediatik ndihmon si gazetarin qytetar dhe atë tradicional të kuptojnë më mirë jo vetëm përdorimin e teknologjisë, por shfrytëzimin e potencialeve të saj për të angazhuar audiencën. Gazetari tradicional ka mundësi të përfitojë nga mundësitë ekzistuese për trajnim, të ofruara nga arsimimi, redaksitë, organizatat apo platformat rajonale të medias. Ndërsa gazetari qytetar është zakonisht i përjashtuar, jo vetëm nga mundësia e trajnimit formal mbi gazetarinë, por edhe nga njohuritë që do e ndihmonin të kuptonte rolin dhe rëndësinë që media ka.

Gazetaria qytetare është ushtrim i parimit themelor demokratik të lirisë së shprehjes dhe media dixhitale ka hapur dritare të reja për ata që më parë nuk kishin mundësi për të ngritur zërin rreth problemeve që i shqetësojnë. Ndaj, adresimi i nevojës së publikut të gjerë për edukim mediatik është në favor të vetë medias e cila mundet të bashkëveprojë me qytetarin.

Një publik i aftësuar, duke u bërë pjesë e procesit të krijimit të lajmit, gjeneron përmbajtje të vlefshme dhe origjinale e cila thyen hierarkinë, sjell lirinë dhe origjinalitetin, vlera që përbëjnë bazën e gazetarisë cilësore.



Kjo rubrikë është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.



The regional program "Media for Citizens – Citizens for the media: Strengthening the Capacity of NGOs for the Development of Media and Information Literacy in the Western Balkans" is implemented with the support of the European Union by partner organizations Mediacentar Sarajevo, Albanian Media Institute, Macedonian Institute for Media, Montenegrin Media Institute, Novi Sad School of Journalism, Peace Institute, SEENPM .